

VENDIM
Nr. 469, datë 26.7.2018

**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS SË
BOTIMEVE PËR DIASPORËN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 23, të ligjit nr. 16/2018, “Për diasporën”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën (në vijim “QBD”), si person juridik publik buxhetor, me seli në Tiranë, në varësi të ministrit përgjegjës për diasporën.

2. QBD-ja është përgjegjëse për:

a) Botimin, në përputhje me ligjin nr. 9616, datë 27.9.2006, “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe me ligjin nr. 35/2016, “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të teksteve që do t’i shërbejnë diasporës;

b) Redaktimin përfundimtar të teksteve që do të botohen;

c) Nxitjen e aksesit *online* të teksteve të veçanta për diasporën;

ç) Nxitjen e krijimit të formateve të posaçme për *e-book*;

d) Bashkërendimin e punës me operatorin ekonomik, i cili bën shpërndarjen e teksteve;

dh) Koordinimin me institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës për botimet për diasporën.

3. Shtypja e teksteve të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi realizohet nga vetë QBD-ja dhe shpenzimet përballohen nga buxheti i shtetit.

4. QBD-ja të përdorë programet e teksteve mësimore të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe botime të tjera me miratimin e ministrit përgjegjës për diasporën.

5. QBD-ja, me kërkesë të ministrit përgjegjës për arsimin dhe pas miratimit të ministrit përgjegjës për diasporën, boton edhe tekste të tjera nga ato të përmendura në pikën 2 të këtij vendimi.

6. QBD-ja drejtohet dhe përfaqësohet nga drejtori, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e qendrës dhe përgjigjet para ministrit përgjegjës për diasporën. Ai emërohet, lirohet ose shkarkohet me urdhër të ministrit përgjegjës për diasporën.

7. Nëpunësit dhe punonjësit e administratës së QBD-së emërohen e lirohen nga drejtori i QBD-së. Marrëdhënia e punës për drejtorin dhe punonjësit e QBD-së rregullohet me Kodin e Punës.

8. Pranë QBD-së funksionon Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën, si organ këshillimor e vendimmarrës për çështjet e botimeve për diasporën.

9. Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën është organ kolegjal, i përbërë nga pesë anëtarë, i cili ka përfaqësues nga:

- ministria përgjegjëse për punët e jashtme;
- ministria përgjegjëse për arsimin;
- ministria përgjegjëse për diasporën.
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë;
- Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë.

10. Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën ka këto kompetenca:

a) Mbledh dhe shqyrton kërkesat vjetore për botime për diasporën dhe shqyrton kërkesat e herëpashershme, të cilat mund të mos jenë parashikuar në kërkesat vjetore;

b) Miraton programet e botimeve të QBD-së, në përputhje me dokumentet strategjike për marrëdhëniet me diasporën;

c) Planifikon shpërndarjen e teksteve të botuara nga qendra;

ç) Merr vendime për çështje të tjera, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi;

d) I propozon ministrit përgjegjës për diasporën botimin e teksteve të tjera;

dh) I propozon ministrit përgjegjës për diasporën çmimet e shitjeve të teksteve, të cilat vendosen duke respektuar dispozitat e ligjit nr. 9616, datë 27.9.2006, të ndryshuar, dhe kategoritë që përfitojnë falas kopje të teksteve të botuara nga QBD-ja, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Ky këshill ka dhe kompetenca të tjera, në përputhje me ligjin, të ngarkuara nga ministri përgjegjës për diasporën ose drejtori i qendrës.

11. Mandati i anëtarëve të Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën është 4 vjet, me të drejtë rrizgjedhjeje.

12. Anëtarët e Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën duhet të jenë drejtues të nivelit të lartë të institucioneve të përfaqësuar, të cilët emërohen dhe shkarkohen me urdhër të ministrit përgjegjës për diasporën, me propozim të titullarit të institucionit përkatës. Ministri përgjegjës për diasporën cakton njërin nga anëtarët si kryetar të këtij këshilli.

13. Kryetari dhe anëtari i Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën shkarkohen para mbarimit të mandatit 4-vjeçar, kur:

a) Lirohet ose shkarkohet nga funksioni drejtues që ushtronte në institucionin që përfaqëson;

b) Me propozim të titullarit të institucionit të përfaqësuar, për shkak të ndryshimit të misionit e të detyrave që ai kryen në atë institucion;

c) Neglizhon kryerjen e detyrave dhe pjesëmarrjen e rregullt në mbledhjet e Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën.

14. Ministri përgjegjës për diasporën, 30 (tridhjetë) ditë para mbarimit të mandatit 4-vjeçar ose menjëherë pas shkarkimit të anëtarit, i kërkon institucionit të përfaqësuar në Këshillin Koordinues të Botimeve për Diasporën paraqitjen e emrit të kandidatit për anëtar të këtij këshilli.

15. Shpërblimi i kryetarit dhe i anëtarëve të Këshillit Koordinues të Botimeve të Diasporës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

16. Struktura dhe organika e QBD-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

17. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të QBD-së miratohen nga ministri përgjegjës për diasporën pas propozimit të drejtorit të saj.

18. QBD-ja është institucion buxhetor që financohet nga buxheti i shtetit.

19. Çmimet e shitjes së teksteve të botuara nga QBD-ja dhe kategoritë që mund t'i përfitojnë falas ato përcaktohen me vendim Këshillit të Ministrave, me bashkëpropozim të ministrit përgjegjës për diasporën dhe të ministrit përgjegjës për financën.

20. QBD-ja ka stemën dhe logon e vet zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë me shënimet “Republika e Shqipërisë”, “Ministri i Shtetit për Diasporën”, “Qendra e Botimeve për Diasporën”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë. Logoja e QBD-së të vendoset në çdo botim, në përputhje me nenin 26, të ligjit 16/2018, “Për diasporën”.

21. Vula e QBD-së ka formën dhe elementet sipas përcaktimit të vendimit të Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

22. Shtëpia Botuese e Teksteve Mësimore (BOTEM), me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, ristrukturohet në Qendra e Botimeve për Diasporën (QBD). Për punonjësit administrativë zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

23. Vendimi nr. 843, datë 2.11.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Shtëpisë Botuese të Teksteve Mësimore (BOTEM)”, i ndryshuar, shfuqizohet.

24. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën, ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Qendra e Botimeve për Diasporën për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2019.

KRYEMINISTRI
Edi Rama